



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 6881/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.557/17, datë 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit nr.557/17, datë 06.07.2017 për këto programe të studimit:
 - Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS;
 - Kontabilitet dhe Financa, MA, 120 ECTS;
 - Juridik i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS;
 - Agro Ekologji dhe Agro Mjedis, BSc, 180 ECTS, dhe
 - Juridiko – Penal, LLM, 60 ECTS.
- III. Lejohet regjistrimi i studenteve në programet e cekura në piken dy të këtij vendimi.
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.557/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë me 21.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 557/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë i është pezulluar akreditimi për shtatë programe të studimit: Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS; Administrim Biznesi, MA, 120 ECTS; Kontabilitet dhe Financa, MA, 120 ECTS; Juridik i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS; Agro Ekologji dhe Agro Mjedis, BSc, 180 ECTS; Juridiko – Penal, LLM, 60 ECTS; Regji Filmi dhe TV, BA, 240 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti "Haxhi Zeka", është konstatuar që pesë nga shtatë programet e cekura me sipër i plotësojnë kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2.

Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti "Haxhi Zeka",
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

